



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202201204/4

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave me qëllim kryerjen e hetimeve objektive, të gjithanshme dhe të shpejta të procedimit penal -----, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.*

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

ELBASAN

Për dijëni: Z. -----
Cel: -----

Të nderuar!

Siç jeni vënë më herët në dijeni me anë të shkresave tona zyrtare, pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka parashtruar një ankesë shtetasi ----- . Ai parashtron se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar kallëzimin penal me nr. ----- datë 07.10.2020 me palë kallëzues ----- dhe të kallëzuar ----- . Me vendimin e datës 26.11.2020 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur mosfillimin e hetimeve. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim gjyqësor. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ----- datë 13.04.2021 ka vendosur pranimin e ankimit dhe kthimin e akteve të materialit kallëzues pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për vazhdimin e hetimeve. Prej asaj kohe, ndonëse kanë kaluar 16 muaj, ankuesi shprehet se nuk ka asnjë informacion lidhur me hetimet e zhvilluara nga Prokuroria. Më datë 05.09.2022, nëpërmjet Avokates së tij, ankuesi i është drejtuar me kërkesë Prokurorisë, lidhur me hetimet që po zhvillohen për këtë kallëzim, por nuk ka asnjë përgjigje.

Sa më sipër ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të familjes së tij.

Në këtë kuadër, për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm nga institucioni ynë të kësaj çështjeje, me tonën nr. K2/A31-2, datë 11.10.2022 janë kërkuar informacione nga ana e organit të Prokurorisë Elbasan lidhur me veprimet hetimore të kryera për këtë çështje, veprimet dhe procedurat e ndërmarra.

Nga shpjegimet e dhëna nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me shkresën nr. 11429/1, datë 13.10.2022, informohemi si vijon:

Ky organ ka regjistruar procedimin penal nr. ----- të vitit 2020 mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit ----- ndaj ----- i cili, pas shortimit elektronik në sistemin CAMS i ka rënë prokurorit Hektor Mushi. Më datë 30.10.2020 ky prokuror për arsye shëndetësore është zëvendësuar me short manual me prokurore Etleva Stafa. Më datë 26.11.2020 prokurore Etleva Stafa ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ky vendim është ankimuar nga shtetasi ----- më datë 29.12.2020. Me vendimin nr. ----- datë 13.04.2021 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është vendosur pranimi i ankimit, kthimi i akteve të materialit kallëzues pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për vijimin e hetimeve.

Materiali referues është regjistruar nga Prokurore Etleva Stafa me nr. ----- datë 30.04.2021. Më datë 23.05.2022 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin nga detyra të Prokurores Etleva Stafa. Në këtë situatë, është bërë zëvendësimi i saj me short manual më datë 09.06.2022 me prokuror Arbër Berexha. Në përfundim, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan na informon se ky procedim penal aktualisht vijon të jetë në fazën e hetimit nga prokurori Arbër Berexha.

Avokati i Popullit konstaton se trajtimi i këtij rasti në tejkalim të afateve të përshtatshme për një proces të rregullt ligjor¹ ka ardhur si rezultat i disa faktorëve. Më poshtë rendisim në kronologji veprimet e kryera nga momenti i regjistrimit të kallëzimit penal deri më datë 13.10.2022 kur jemi informuar nga Prokuroria Elbasan:

- *Më datë 07.10.2020 është regjistruar kallëzimi penal;*
- *Më datë 30.10.2020 është zëvendësuar prokurori për arsye shëndetësore*
- *Më datë 26.11.2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal;*
- *Më datë 13.04.2021 është vendosur kthimi i akteve me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan*
- *Më datë 23.05.2022 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin nga detyra të Prokurores Etleva Stafa;*
- *Më datë 09.06.2022 është bërë zëvendësimi i prokurorit dhe cështja i është caktuar prokurorit Arbër Berexha.*

Pra, pasi është vendosur kthimi i akteve me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, dhe regjistrimit të procedimit penal nr. ----- datë 30.04.2021, nga përgjigja nuk evidentohet se çfarë veprimesh hetimore janë kryer deri më tani, nëse është marrë vendim për zgjatjen e afateve të hetimit dhe nëse është njoftuar viktimat (kallëzuesi -----) për të gjitha këto nga organi i prokurorisë.

Procedurat hetimore për këtë rast janë zvarritur ndër të tjera edhe për shkak të ndërrimit të tre prokurorëve, çka ka ardhur edhe si rezultat i zhvillimit të procesit të rivlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët gjatë së cilit është prekur edhe prokurori i ngarkuar me kryerjen dhe ndjekjen e procedurave hetimore. Megjithatë, duke mirëkuptuar dhe vlerësuar volumin e punës dhe vështirësitë me të cilat po përballen aktualisht strukturat e organeve të drejtësisë për shkak të mungesave në burimet njerëzore, Avokati i Popullit mbështet qëndrimin se aksesimi në drejtësi dhe zbatimi me rigorozitet i parimeve bazë të një procesi të rregullt ligjor, duhet të udhëheqin punën dhe veprimtarinë e organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

¹ Në nenin 323 “Afati i hetimeve paraprake” të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet si vijon:

1. Brenda përfundimit të afatit ligjor të hetimeve, prokurori vendos sipas paragrafit 6, të nenit 327, të këtij Kodi. 2. Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shenuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, dhe gjashtë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 75/a, të këtij Kodi.

Në këto kushte, në vlerësimin dhe gjykimin e Avokatit të Popullit, nuk ka tashmë asnjë pengesë ligjore dhe procedurale për vijimin e veprimeve dhe hetimin e mëtejshëm të procedimit penal nr. ----- datë 30.04.2021, në zbatim të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale.

Duke vlerësuar jo vetëm kompleksitetin e ngjarjes, por edhe vakancat në burimet njerëzore që mund të jenë krijuar pranë organit të Prokurorisë Elbasan, Avokati i Popullit çmon se duhen marrë masat e nevojshme dhe efektive për të evituar zvarritje të mëtejshme dhe të pajustificuara në ndjekjen dhe kryerjen e veprimeve hetimore, çka në rast të kundërt do të përbente cënim të një procesi të rregullt ligjor. Veprimet dhe zvarritjet e pajustificuara bien ndesh me nenin 42 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”*.

E drejta për një proces të rregullt ligjor parashikohet në nenin 131/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Garancitë e parashikuara në nenin 6 zbatohen jo vetëm në proceset gjyqësore, por edhe në fazat që paraprijnë dhe pasojnë ato. Duke qenë një e drejtë kushtetuese, e drejta për një proces të rregullt ligjor e vendos organin procedues para një sërë detyrimesh, si në respektimin e të drejtave procedurale dhe zhvillimin e hetimit e gjykimit brenda një *“afati të arsyeshëm”*, pa lejuar zvarritje të papërligjura dhe arbitrare prej tij. Shpejtimi i procedurave të hetimit dhe gjykimit është i lidhur drejtpërsëdrejti me të drejtat dhe liritë themelore nga njëra anë, dhe detyrimin për realizimin e një hetimi e gjykimi objektiv, të plotë, të saktë e të shpejtë nga ana tjetër.

Nga ana tjetër, Avokati i Popullit gjatë trajtimit të rasteve në vijimësi, ka vendosur theksin në respektimin e të drejtës së qytetarit për t’u informuar me vendimet përfundimtare apo të ndërmjetme të Prokurorisë, duke synuar në garantimin e të drejtës së ankimit që duhet t’u njihet individëve ndaj vendimeve repektive në çdo fazë të hetimit.

Kjo problematikë evidentohet edhe më tepër për shkak të reduktimit maksimal të numrit të prokurorëve në të gjitha nivelet², duke shkaktuar edhe një cënim të standardit të një procesi të rregullt ligjor, në të gjitha dimensionet e tij. Situata dhe realiteti është larg situatës normale të ushtrimit të përgjegjësive dhe kompetencave ligjore nga ana e organit të Prokurorisë në mbrojtjen e marrëdhënieve juridike dhe garantimin e të drejtave të individëve që cënohen nga vepra të ndryshme penale dhe që kërkojnë ndihmën dhe mbrojtjen e strukturave të shtetit, detyrë e cila në rastin konkret duhet të ushtrohet nga Prokuroria brenda një afati sa më të arsyeshëm.

Sa më sipër, e çmojmë të drejtë ankesën e shtetasit -----, dhe për këtë do të rekomandonim vlerësimin e shqetësimit të tij, dhe me qëllim për të vënë në vënd të drejtën e shkelur, shpejtimin e kryerjes së veprimeve hetimore dhe përfundimin sa më parë të hetimit të procedimit penal, duke respektuar edhe kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Rasti i mësipërm duhet të bëhet objekt i analizës së punës së Prokurorisë duke vënë theksin në hetimet e shpejta, njoftimin

² Referuar të dhënave të raportuara në Progres Raportet e Bashkimit Evropian për Shqipërinë në vitet 2021 dhe 2022 të cilët pasqyrojnë përkatësisht situatën e vitit 2020 dhe atë të vitit 2021, rezulton se Shqipëria ka 300 pozicione prokuror me kohë të plotë (10.5 për 100,000 banorë). Sipas Komisionit për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), mesatarja evropiane është 12 prokurorë për 100 000 banorë.

Raporti i vitit 2021, f.21: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/7532fb68-5bd9-4620-ae9c-1df47d34b919_en?filename=Albania-Report-2021.pdf

Raporti i vitit 2021, f.21: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/dde85556-8061-41f3-ba0c-5e921158bc53_en?filename=Albania%20Report%202022.pdf

sa më parë të palëve në procesin penal për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve, ecurinë e hetimit dhe veprimet hetimore të kyera, deri në marrjen e vendimit përfundimtar të hetimit.

Nga ana tjetër, ankuesi ka ngritur edhe shqetësimin e mungesës së informacionit sa i takon hetimeve të zhvilluara nga Prokuroria ndonëse kanë kaluar 16 muaj. Ai parashtron se më datë 05.09.2022 i është drejtuar me kërkesë për informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (kopje të së cilës e ka depozituar dhe në ankesë), por nuk ka marrë përgjigje apo informacion nga prokuroria. Në kërkesën për shpjegime të Avokatit të Popullit nr. K2/A31-2, datë 11.10.2022 është kërkuar informacion në lidhje me trajtimin e kësaj kërkesë, duke bashkëlidhur dhe një kopje të saj. Megjithatë, në shpjegimet e dhëna nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me shkresën nr. 11429/1, datë 13.10.2022, sic u përmend dhe më herët, nuk evidentohet ndonjë informacion konkret se çfarë veprimesh janë për nëse njoftimin e viktimës (kallëzuesi -----) lidhur me fazat e hetimit.

Institucioni i Avokatit të Popullit vendos theksin tek rëndësia që ka transparenca dhe drejta e palëve për informim si element thelbësor i të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Rritja e besimit që qytetarët duhet të kenë tek sistemi i drejtësisë mund të realizohet vetëm me ndryshimin e qasjes së organit të Prokurorisë sa i takon informimit të qytetarëve.

Për të gjitha arsyet që parashtruam, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime, nenit 8 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 21/b, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar”, në të cilin thuhet se: “Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË

- *Marrjen e masave me qëllim kryerjen e hetimeve objektive, të gjithanshme dhe të shpejta të procedimit penal nr. ----- datë 30.04.2021, dhe njoftimin e viktimës (kallëzuesit) nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në zbatim të dispozitave kushtetuese e procedurale ligjore, në kuadër të procesit të rregullt ligjor.*

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar me Ligjin Nr.9398 dt.12.05.2005, ku thuhet se:

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”,

kërkojmë të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R E

Ermonela RUSPI